



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2013
Nr. ref.: RK529/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI97/13

Parashtrues

Tahir Bytyqi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të
Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 13/2013, të 30 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Tahir Bytyqi nga fshati Shkozë, komuna e Malishevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), të cilin në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson avokati z. Rexhep Hasani nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 13/2013, i 30 prillit 2013 e është dorëzuar 23 maj 2013. me të cilin është refuzuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykime Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 13/2013, i 30 prillit 2013 me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese caktimin e masës së përkohshme: “*ndalimin-pezullimin e fillimit të vuajtjes së dënimit të shqiptuar derisa Gjykata Kushtetuese të nxjerrë vendimin përfundimtar*”.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 27 dhe 48 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 28 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 qershor 2013, parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 5 maj 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI97/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit, nr. KSH. KI97/13, është caktuar Kolegji shqyrtyes, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 30 gusht 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve në rastin nr. KI97/13.
9. Më 16 tetor 2013, pas shqyrimit të rapportit të gjyqtarit Kadri Kryeziu, , i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.
10. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtyes i rekmandoit Gjykatës në përbërje të plotë refuzimin e kërkesës së parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme, me arsyetimin se i njëjti nuk ka paraqitur ndonjë provë bindëse për të arsyetuar vendosjen e masës së përkohshme si të nevojshme për të evitar një dëm të pariparueshëm, ose ndonjë provë se vendosja e një mase të tillë është në interes publik.

Përbledhja e fakteve

11. Më 17 nëntor 2011, kundër parashtruesit të kérkesës, Prokuroria e Qarkut në Prizren ngriti aktakuzën P. P. nr. 256/2011 mbi dyshimin e bazuar se më 27 shtator 2011, ka kryer veprat penale të vrasjes në tentativë nga neni 146, në lidhje me nenin 20 dhe mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, paragrafi 2 i LPK-së.
12. Më 2 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 283/2011, konfirmoi Aktakuzën e ngritur P. P. nr. 256/2011, të 17 nëntorit 2011, dhe parashtruesi i kérkesës u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, paragrafi 2 të LPK-së dhe dënohet me dënim unik të burgimit prej 3 (tri) vjet e 6 (gjashtë) muaj.
13. Më 23 mars 2012, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 283/2011, të 2 shkurtit 2012, brenda afatit ligjor, parashtruesi i kérkesës ushtroi ankesë përmes avokatëve të tij mbrojtës, Hysen Gashi dhe Rexhep Hasani, duke kundërshtuar aktgjykimin e kontestuar nga disa baza ligjore.
14. Më 26 shtator 2012, duke vendosur lidhur me ankesën, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin A. P. nr. 162/2012, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar nga parashtruesi dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 283/2011, të 2 shkurtit 2012.
15. Më 15 janar 2013, parashtruesi i kérkesës ia paraqiti mjetin e jashtëzakonshëm, kérkesën për mbrojtje të ligshmërisë, Gjykatës Supreme të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të LPK-së, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë si e bazuar, si dhe të prishen aktgjykimet e kontestuara (P. nr. 283/2011, të 2 shkurtit 2012 dhe A. P. nr. 162/2012) dhe lënda të kthehet në rigjykim.
16. Më 30 prill 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 13/2013, refuzoi si të pabazuar mjetin e jashtëzakonshëm – kérkesën për mbrojtjen e ligshmërisë. Gjykata Supreme konstatoi se çështjet të cilat u ngritën nga parashtruesi i kérkesës në kérkesën për mbrojtjen e ligshmërisë në lidhje me shkeljet e ligjit në të dëm të dënuarit, janë të pabazuara.

“Nuk qëndrojnë as pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit T.B. se i njëjti nuk pati dashje për ta privuar nga jeta personin e panjohur, R.T., por veprimet i ndërmori nga pakujdesia dhe në gjendje afekti, ngase, siç shihet nga foto-dokumentacioni dhe provat e tjera, cak i sulmit nuk ishte para së gjithash vetura, por i dëmtuari R.T.. Për dashjen e të akuzuarit flasin edhe faktet se, në pamundësi për ta ndalur automjetin me goditjen me sëpatë, i dënuari shtiu me revole disa herë në drejtim të automjetit, i cili ishte në lëvizje, me ç'rast e godit atë ne pjesë të ndryshme të kokës –në pjesën më vitale të trupit dhe, për pasojë, i shkakton plagë të rënda, prandaj në rastin konkret assesi nuk mund të bëhet fjalë për atë se i dënuari i kishte

ndërmarrë veprimet nga pakujdesia dhe në gjendje afekti, siç pretendon mbrojtësi i të dënuarit.”

“Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të të dënuarit Tahir Bytyqi se i dëmtuari nuk është marre në pyetje nëasnë faze të procedurës penale, kur do të dëshmone për të gjitha faktet dhe rrëthanat e rastit shumë me peshë, kjo Gjykatë vlerëson se as në këtë drejtim nuk është bërë shkelje procedurale as nga gjykata e shkallës së parë, as ajo e shkallës së dytë, për faktin se ka qenë e pamundur që i dënuari Tahir Bytyqi të merrej në pyetje dhe të deklarohej qoftë para organit të akuzës, qoftë në seancat gjyqësore, për shkak të gjendjes së rendë shëndetësore të tij, ndërsa me provat e tjera që ndodhen në shkresat e çështjes është vërtetuar gjendja faktike, për çka janë dhënë arsyet e mjaftueshme në faqen nëntë të aktgjykimit të shkallës së parë, miratuar nga gjykata e shkallës së dytë, të cilat, si të tilla, i aprovoi edhe kolegji i kësaj Gjykatë.”

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës kërkon që

“aktgjykimet e përmendura të bashkangjitura kësaj kërkesë të anulohen dhe atë për të vetmin qëllim që t'i jepet e drejta Kushtetuese nga neni 31, paragrafi të Kushtetutës të Republikës së Kosovës për të drejtën për tu ballafaquar me të dëmtuarin (...), me qenë se mendon se padrejtësisht iu ka mohuar dhe cenuar e drejta për ballafaqim me personin për shkak të se cilit është akuzuar dhe gjykuar.”

Kërkesa për masën e përkohshme

18. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon:

“Që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, të merr VENDIM për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Gjykatës Themelore në Gjakovë Dega në Malishevë mbi ndalimin-pezullimin e ekzekutimit te dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 3 vjet e 6 muaj ndaj të dënuarit Tahir Bytyqi, dëni i shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 283/2011 të datës 02.02.2012, tanë në kompetencë të Gjykatës Themelore në Gjakovëme numër ekzekutimi PED. nr. 4/13.”

19. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 27 të Ligjit, i cili përcakton:

“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësish masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqet ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.”

20. Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë refuzimin e kërkesës së parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme, me arsyetimin se i njëjtë nuk ka dorëzuar ndonjë provë bindëse për të arsyetuar vendosjen e

masës së përkohshme si të nevojshme për të evituar një dëm të pariparueshëm, ose ndonjë provë se vendosja e një mase të tillë është në interes publik.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113. [Juridikzioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike t përcaktuara me ligj”.

22. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

23. Për më tepër, rregulli 36 (2) b) i Regullores parasheh që

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura nëasnje mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”

24. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe me aktgjykitet e gjykatës së shkallës së dytë i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 paragrafi 4 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].
25. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë për shkak të „*shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim ta NDRYSHOJË aktgjykimin përkitazi me cilësimin juridik, dhe te akuzuarit ti shqiptohet një dënim shumë me i butë*”.
26. Gjykata Supreme, pas analizës së tërësishme të bazës së ankesës, gjeti se „*pretendimet ankimore të lartekura janë të pabazuara*”.
27. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme për shkak të: „*shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, si dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të LPK, me propozim që kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ta pranojë si të bazuar, aktgjykitet e kundërshtuara ti anulojë dhe çështjen ta kthejë për rigjykim.*” Gjykata Supreme (Pml. nr. 13/13, të 30 prillit 2013) pas shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se kërkesa është e pabazuar.

28. Gjykata Kushtetuese më tej vëren se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 283/2011, i 2 shkurtit 2012, është arsyetuar dhe kjo gjykatë nuk ka vërejtur se gjatë procesit të gjykimit të lëndës ka pasur shkelje të procedurës, të cilat do të rezultonin me shkeljen e të drejtave themelore të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë. Parashtruesit të kërkesës i janë ofruar të gjitha mundësitetë për mbrojtje gjatë gjithë procesit të gjykimit të rastit.
29. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për të dëgjuar dëshmitarin, në faqen 9 të aktgjykimit të gjykatës së shkalles së parë, mund të shohim deklaratën e ekspertit mjeko-ligjor, i cili në seancën gjyqësore ka thënë se: “*edhe po të dëgjohej dëshmia e tij varësisht prej gjendjes së tij shëndetësore për shkak se nga lëndimet e marra ekziston besueshmëria e madhe se atij i është prekur dhe aftësia mendore dhe psikike, dëshmia e të dëmtuarit do të vinte në dyshim lidhur me besueshmërinë e saj, e këtë fakt e vërteton prokurori publik i cili ka qenë në QKUK në Prishtinë për të marr në pyetje të dëmtuarin R. T. dhe vet në mënyrë okulare ka vërejtur se ka qenë e pamundur dëgjimi i tij (...) kështu edhe trupi gjykues duke marr parasysh se gjendja faktike është vërtetuar në tërësi dhe duke marr parasysh pamundësinë e dëgjimit të dëmtuarit R. T. për shkak të fakteve te cilat janë cekur më lart, të njëjtin nuk e ka marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, sepse edhe pa marrjen e tij në pyetje gjendja faktike sipas qëndrimit dhe përfundimit të kësaj gjykate është vërtetuar në mënyrë të plotë.*
30. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar dhe nuk e ka dëshmuar shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij nga Gjykata e Qarkut dhe nga Gjykata Supreme.
31. Për më tepër, Gjykata vëren se, për të pasur një rast *prima facie* që përbush kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi duhet të dëshmojë se procedurat në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme, shikuar në tëresinë e tyre, nuk janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të këtë pasur një gjykim të drejtë, apo që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese mund të jenë kryer nga ana e gjykatave të rregullta gjatë procesit të gjykimit.
32. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese t'i trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përderisa ato nuk shkelin të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
33. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë, në rastin konkret, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
34. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon pse dhe si janë shkelur të drejtat e tij, ai nuk e mbështet pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës janë shkelur nga ana e gjykatave të rregullta.

35. Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se proceduarat përkatëse në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrale (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
36. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës as nuk e ka ndërtuar, e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie*, qoftë në bazën e meritave, apo pranueshmërisë së kërkesës.
37. Në tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 48 të Ligjit, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, më 16 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazeten Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

